



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 4154 Prot.  
5

Tiranë, më 22/01/2013

**Lënda:** Urdhër për kontrolluesin **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**.

**U R D H E R**  
Nr 03 ,datë 22/01 2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr.225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**;

**KONSTATOVA**

Në zbatim të Urdhërit nr.203, datë 07.11.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë** me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në publikimin e të dhënave sipas vendimeve gjyqësore nga kontrolluesi bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.**

Në përfundim të kontrollit administrativ rezultoi se:

- Aktualisht, kontrolluesi përdor “Sistemin e Qeverisjes së Gjykatës” (program i ArkIT) përmes të cilit të dhënat hidhen, ruhen në databazën e serverit të brendshëm. Të dhënat do të publikoheshin online në momentin e riparimit dhe konfigurimit të serverit të sistemit ICMIS, i cili do të realizonte konvertimin dhe replikimin e databazës aktuale dhe publikimin e saj në portalin online të Gjykatave. Grupi i kontrollit konstatoi se, në portalin online të Gjykatave në adresën: [http://gjykata.gov.al/portal\\_main/Courts.aspx](http://gjykata.gov.al/portal_main/Courts.aspx) në faqen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk rezulton i publikuar asnjë vendim.
- Kontrolluesi ka një nivel të përshtatshëm sigurie në ambientet e rrjetit të brendshëm dhe dhomën e serverit dhe specialisti IT i kontrolluesit ndjek masa konkrete për këtë qëllim



si: konfigurim i aksesit të kufizuar në sistem përmes fjalëkalimit, *backupe* të databazës së serverit dhe program AntiVirus të rinovuar periodikisht.

- Nga grupi i kontrollit u tërhoqën në cilësinë e provës shkresore Urdhëri dhe Rregullorja e Brendshme nr. prot 335, datë 10.09.2012 “Për publikimin dhe përpunimin e të dhënave personale” që ishin miratuar nga Kryetari i Gjykatës me qëllim vënien në funksionim në momentin e publikimit të vendimeve gjyqësore dhe në momentin e përdorimit të sistemit ICMIS. Kjo rregullore ka dalë në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”. Sa më sipër rezulton se nga kontrolluesi janë hartuar rregulla për mënyrën e mbledhjes, përdorimit, konfidencialitetit dhe ruajtjes në *Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore* të të dhënave personale të subjekteve që marrin pjesë në proceset gjyqësore.
- Por, nga kontrolli administrativ rezultoi gjithashtu se: Nuk ka rregulla të shkruara ku të jenë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e kompanisë e cila menaxhon anën teknike të “*Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore*”, si dhe kompanisë që menaxhon faqen zyrtare në internet, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve pjesëmarrës në proceset gjyqësore. Kontrolluesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk disponon një kontratë të shkruar në lidhje me administrimin, shërbimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ICMIC (sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore).
- Gjithashtu, nuk konstatohet një dokument i shkruar në të cilën të jenë të përcaktuara qartë nivelet e aksesit dhe rregullimi i marrëdhënieve me kontrolluesin Ministria e Drejtësisë.

Për sa më sipër parashtruar, kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk respekton plotësisht dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.

**Sa më sipër:**

## **URDHËROJ**

1. Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” dhe udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*”:
  - Të pezullohet publikimi në faqen zyrtare në internet, i vendimeve gjyqësore dhe çdo dokumentacioni që mbart të dhëna personale (*të pa anonimizuara*), të subjekteve që marrin pjesë në këto procese gjyqësore, deri në marrjen e masave ku publikimi i tyre, të bëhet me të dhënat personale të anonimizuara, konform kërkesave të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 15 datë 23/12/2011 “*Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor*”
  - Të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e kërkesave ligjore të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen

e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” të përshkruara në Rregulloren e Brendshme nr. prot 335, datë 10.09.2012 të miratuar nga titullari i kontrolluesit.

- Të hartohen rregulla për mënyrën e mbledhjes, përdorimit, konfidencialitetit dhe ruajtjes në *Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore* të të dhënave personale të subjekteve që marrin pjesë në proceset gjyqësore.
- Të përcaktohen rregulla të shkruara ku të jenë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e kompanisë e cila menaxhon anën teknike të programit ICMIS, si dhe kompanisë që menaxhon faqen zyrtare në internet, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve pjesëmarrës në proceset gjyqësore.

2. Kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë Urdhër.

3. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... *Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Flora ÇABEJ (POGAÇE)**

